



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
KOSOVA HANDBALL FEDERATION
RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

EDICIONI 2025/26

PROPOZICIONET E GARAVE PËR GRUPMOSHAT E REJA MESHKUJT DHE FEMRAT



Përmbajtja

I.	Parathënie.....	2
II.	Pjesa e Përgjithshme	2
III.	Liga e Juniorëve	4
IV.	Liga e kadetëve meshkujt dhe femrat.....	4
V.	Kadetët e rinj pionierët dhe pionieret.....	5
VI.	Liga e fatosave meshkujt dhe femrat	5
VII.	Dënimet.....	6
VIII.	Afatet ligjore	7
IX.	Përmbyllja	9

I. Parathënie

- 1.1. Në bazë të nenit 6 pika alineja e 5-të e Statutit të FHK, në mbledhjen e vet të mbajtur më 06.07.2025 me propozim të Komisarit të garave pas diskutimit publik me skuadrat, shoqatat dhe punëtorët sportiv Bordi i FHK-së miratoi:
- 1.2. Propozicionet e garave për Ligën e juniorëve , Ligën e kadetëve dhe kadeteve , të Ligës së pionierëve dhe pioniereve, të Ligës së fatosave dhe fotoseve për vitin garues 2025/2026.
- 1.3. Me këto propozicione përcaktohet mënyra dhe kushtet e zhvillimit të garave në Ligën e juniorëve , Ligën e kadetëve dhe kadeteve , të Ligës së pionierëve dhe pioniereve të Ligës së fatosave dhe fotoseve dhe U12 për vitin garues 2025/2026.
- 1.4. Te gjitha rastet kontestuese te cilat nuk janë te parapara me këto propozicioni praktikohen Propozicionet e përgjithshme dhe aktet tjera normative te miratuara nga Bordi i FHK-së.

II. Pjesa e Përgjithshme

- 2.1. Me këto propozicione përcaktohet mënyra dhe kushtet e zhvillimit të garave në ligën e grup moshave të reja (junior, kadetë dhe pionierë e fatosat), për meshkuj dhe femra.
- 2.2. Garat i udhëheq Komisari i garave të cilën e zgjedh bordi i FHK-së, çdo vit garues.
- 2.3. Garat e grup moshave të reja zhvillohen për ekipet e meshkujve dhe femrave sipas kategorive të caktuara.
- 2.4. Nëse në garat shtesë ndeshja përfundon me rezultat të barabartë atëherë ndeshja vazhdohet me 2 x 5 min. Nëse edhe në këtë rast rezultati është barazim fituesi do të përcaktohet me ekzekutimin e 5 shtashevë nga lojtarët e ndryshëm. Nëse edhe atëherë e kemi rezultatin e barabartë, loja vazhdon me ekzekutimin me nga 5 shtatsheve nga lojtarët e ndryshëm. Nëse edhe pas ekzekutimit të shtatsheve rezultati mbetet baraz ekzekutohen nga një shtatëshe deri në fitore definitive (këto shtatshe mund të ekzekutojë i njëjti lojtarë). Me short do të caktohet skuadra e cila e para do të ekzekutojë shtatshet, ndërsa portën e zgjedhin gjyqtarët.
- 2.5. Garat e juniorëve kadetëve pionierëve-ve dhe kadetëve-ve zhvillohen sipas rregullave të lojës, propozicioneve ndërkombëtare të lojës dhe të akteve normative të Federatës së Hendbollit të Kosovës.
- 2.6. Ekipet në procesverbal (protokoll) të ndeshjes mund të paraqesin nga 16 lojtarë-e.
Pikët pas ndeshjes së përfunduar fitohen në këtë mënyrë:
Për fitore 2 pikë
Për barazim 1 pikë
Për humbje 0 pikë.
- 2.6.1. Skuadrat e kadeteve kadetëve si dhe kadeteve dhe kadetëve te rinj dhe fatosat dhe fatoeset e reja janë të obliguar që në formacion në procesverbalin e ndeshjes dhe në fushë ti kenë minimum 12 lojtare respektivisht lojtarë.

- 2.6.2. Skuadra e cila nuk i përmbahet nenit 2.6.1 do të dënohet si vijon:
- Skuadra e kadetëve dhe kadetëve të ri (pionierët) gjobiten me 50 €
 - Skuadra e kadeteve dhe kadeteve të reja (pionieret) gjobiten me 50 €

GRUP – MOSHAT E REJA – MESHKUJT

	Kategoria	Viti i lindjes	Kohë zgjatja e lojës
1	Juniorët	2006 dhe më të rinj	2 x 30 min.
2	Kadetët	2008 dhe më të rinj	2 x 25 min.
3	Pionierët	2010 dhe më të rinj	2 x 20 min.
4	Fatosat	2012 dhe më të rinj	2 x 15 min.
5	U12	2014 dhe më të rinj	2 x 12 min.

GRUP - MOSHAT E REJA – FEMRAT

	Kategoria	Viti i lindjes	Kohë zgjatja e lojës
1	Kadetet	2008 dhe më të rinj	2 x 25 min.
2	Pionieret	20010 dhe më të rinj	2 x 20 min.
3	Fatoset	2012 dhe më të rinj	2 x 15 min.
4	U12	2014 dhe më të rinj	2 x 12 min.

Të gjitha ndeshjet kampionale zhvillohen në palestra sportive të cilat janë me propozicione të FHK-së.

- 2.7. Për garat e rregullta ndeshjet zhvillohen me topa sipas këtyre madhësive dhe peshës:
- Meshkujt – me të vjetër se 16 vjeç topi nr. 3 dim. (58-60 cm) 425-475 gr.
 - Meshkujt – më të vjetër se 14 vjeç me topat nr. 2 dim. (54-56 cm) 325-375 gr.
 - Meshkujt – më të vjetër se 12 vjeç topat me nr. 1 dim. (50-52 cm) 290-330 gr.
 - Femrat – më të vjetra se 16 vjeç topat me nr. 2 dim (54-56 cm) 325-375 gr.
 - Femrat – më të vjetra se 12 vjeç topat nr. 1 dim (50-52 cm) 290-330 gr.
- 2.8. Orari i zhvillimit të ndeshjeve (juniorët, kadetët) në konkurrencën e meshkujve dhe femrave harmonizohet me orarin e zhvillimit të ndeshjeve të seniorëve të cilët ndeshje të të rinjëve zhvillohen në para lojë të seniorëve/ve, ndërsa ndeshjet (garat) të pionerëve dhe fatosave meshkujt dhe femrat zhvillohen në grupe A,B dhe C.
- 2.9. Liga e juniorëve fillon dhe zhvillohet gjatë fazës së dytë të kampionatit që i bie në edicioni pranveror duhet të ndahet në dy grupe, Gr- A,dhe Gr-B,dhe sistemi i kesaj lige është vajtje ardhje,dhe play-of.
- 2.10. Liga e kadetëve/ve zhvillohet paralojë të ndeshjeve të seniorëve gjatë fazës së parë të kampionatit.
- 2.11. Liga e pioniereve meshkujt zhvillohet në paralojë të ndeshjeve të seniorëve gjatë fazës së dytë të kampionatit.
- 2.12. Liga e fatosave meshkujt femrat zhvillohet në sistem të grumbullimit të ndarë në grupe.

III. Liga e Juniorëve

- 3.1. Liga e Juniorëve i zhvillon ndeshjet në pjesën e dytë të kampionatit, fillon në muajin shkurt ose mars 2026, mvarsisht prej kalendarit të garave. Pjesmarja për skuadrat e Superligës është obligative, nga ana tjetër, për ekipet e ligës së parë, ato zgjedhin të marrin pjesë. Struktura e garës është e ndarë në dy grupe, A dhe B. Secili grup zhvillon ndeshjet në sistemin vajtje-ardhje, ku skuadrat përballen me njëra-tjetrën dy herë, një herë në fushën e tyre dhe një herë si mysafire. Në fund të fazës së rregullt, liga do të ketë edhe fazën e Final4, ku takohen dy skuadrat e para nga secili grup. Keto ndeshjet janë vendimtare dhe vendosin se cila skuadër do të shpallet kampion.
- 3.2. Lojtari juniorë ka të drejtë të paraqitet në lojë për skuadrën e seniorëve, por jo në të njëjtën ditë kur luan edhe për skuadrën e juniorëve, paraqitja e tij nënkupton regjistrimin e ndeshjes me rezultat zyrtar 0:10 për kundërshtarin.
- 3.3. Skuadra e cila renditet e para në fund të edicionit shpallet Kampion i Kosovës për edicionin e garave 2025/26, Skuadra fituese nderohet me Kupën e FHK-së, kurse 3 skuadrat e para edhe me medalje.
- 3.4. Trajneri i cili e udhëheq skuadrën e juniorëve dhe nëse ndëshkohet me karton të kuq apo të kaltërt, ai pezullohet dhe nuk ka të drejtë të paraqitet në skuadrën e seniorëve nëse ndeshja zhvillohet atë ditë.
- 3.5. Skuadra e seniorëve në Superligën e meshkujt, e cila nuk paraqitet në gara me ekipin e juniorëve automatikisht përjashtohet nga garat e mëtutjeshme edhe me ekipin e parë (seniorët).

IV. Liga e kadetëve meshkujt dhe femrat

- 4.1. **Skuadrat e grup-moshës së kadetëve dhe kadeteve** zhvillojnë ndeshjet sipas rotacionit të dyfishtë, me sistem të dyfishtë të pikëve, vajtje – ardhje gjatë stinorit vjeshtë të meshkujt dhe vjeshtë-pranverë të femrat.
- 4.2. 4 skuadrat e renditur të parat pas garave të rregullta, zhvillojnë pjesën e Final4. Fituesi i saj shpallet Kampion i Kosovës për edicionin 2025/26.
- 4.3. Gjithashtu Liga e kadeteve i zhvillon garat në pjesën e parë të kampionatit para ndeshjeve të skuadrave të seniorëve me sistem të garave vajtje ardhje. 4 skuadrat e renditur të parat pas garave të rregullta, zhvillojnë pjesën e Final4. Fituesi i saj shpallet Kampion i Kosovës për edicionin 2025/26.
- 4.4. Skuadra fituese në fund të edicionit shpallet Kampion i Kosovës për edicionin e garave 2025/26, nderohet me Kupën e FHK-së.

V. Kadetët e rinj pionierët dhe pionieret

- 5.1. **Gara e grup-moshës së pionierëve (m)** zhvillohet para ndeshjes së seniorëve në Superligën e meshkujve në pjesën pranverore të edicionit 2025/26. Skuadrat e Superligës dhe Ligës së parë në të dy konkurrencat janë të obliguara që të paraqesin skuadrat e kësaj grup-moshe për gara, në të kundërtën skuadra e parë (seniorët) do të dënohet me marrjen e 2 (dy) pikëve dhe 500 euro, dhe në edicionin e garave 2026/27 starton me – 2 pikë.
- 5.2. **Gara e grup-moshës së pionierëve (f)** zhvillohet sipas kalendarit të garave në pjesën pranverore dhe vjeshtore të edicionit 2025/26. Skuadrat e Superligës dhe Ligës së parë në të dy konkurrencat janë të obliguara që të paraqesin skuadrat e kësaj grup-moshe për gara, në të kundërtën skuadra e parë (seniorët) do të dënohet me marrjen e 2 (dy) pikëve dhe 500 euro, dhe në edicionin e garave 2026/27 starton me – 2 pikë.
- 5.2.6 skuadra të Superligave do të jenë pjesë e garave shtesë ndërsa 2 do të jenë nga Ligat e para. 8 skuadrat e cekura do të jenë pjesë e garave shtesë që zhvillohen sipas sistemit të Kupës, pra ndeshjet çerekfinale, ndeshjet gjysmëfinale dhe ndeshjet finale.
- 5.3. Mos pjesëmarrja në ndeshjet e play off-it në Ligen e pionierëve dhe pionierëve do të sanksionohet me 200 € gjobë.
- 5.3.1. Ndeshja në garat e pionierëve zgjatë 40 minuta (2 x 20 min) gjatë zhvillimit të ndeshjes Skuadrave ju ndalohet sistemi i lojës, 6 : 0 - 5 + 1 dhe 4 + 2, njëkohësisht nuk lejohet lojtarin sulmues të ruhet (fllaster) në mënyrë që mos të deri të posedimi i topit, ose të ndiqet nga do që lëviz në fushën e lojës. Kurse skuadrave ju lejohet, të zhvillojnë ndeshjen në këtë sistem, - 3 : 3, - 3 : 2 : 1, - 5 : 1 dhe 4 : 2. Madhësia e topit 2. Mos respektimi i këtij paragrafi vëzhguesi-kontrolluesi i ndeshjes, është i obliguar që të paraqes në formularin nr.19 (Fletëparaqitje).
- 5.4. Skuadra e cila renditet e para në fund të edicionit shpallet Kampion i Kosovës për edicionin e garave 2025/26. Skuadra fituese nderohet me Kupën e FHK-së, kurse 3 skuadrat e para edhe me medalje.

VI. Liga e fatosave meshkujt dhe femrat

- 6.1. **Gara e grup-moshës së fatosëve dhe fatoseve** zhvillohet me sistem grumbullimi në pjesën pranverë, dhe skuadrat e Superligës dhe Ligës së parë në të dy konkurrencat janë të obliguara që të paraqesin skuadrat e kësaj grup-moshe për gara të cilat zhvillohen të ndara në grupe A, B, C, D në të kundërtën skuadra e parë (seniorët) do të dënohet me marrjen e 2 (dy) pikëve dhe 500 euro, dhe në edicionin e garave 2026/27 starton me – 2 pikë.
- 6.1.1. Skuadrat e grup-moshës së **fatosët dhe fatoset** zhvillojnë ndeshjet sipas sistemit të dyfishtë të garave vetëm në pranverë.
- 6.1.2. Garat i zhvillojnë në muajin maj 2026, dy skuadrat e renditura në vendet e parë dhe të dytë në grupin A, B, C dhe D do të jenë pjesë e garave shtesë prej 8 skuadrat e cekura do të jenë pjesë e garave shtesë që zhvillohen sipas sistemit të Kupës, pra ndeshjet çerekfinale, ndeshjet gjysmëfinale dhe ndeshjet finale, në rastet kur kemi të bëjmë me tri grupe do të kualifikohen dy skuadrat e renditura në vendin e parë në grupin A, B dhe C nga tri grupet dy skuadrat më të mira për nga rezultatet që plasohen në vendet e treta në grupet A, B dhe C do të kualifikohen në garat

shtesë. Kurse ne rastet kur kemi të bëjmë me dy grupet 4 skuadrat e renditura nga 2 grupet do te kualifikohen në ndeshjet çerekfinale te cilat do të zhvillojnë garë 1 grupit me te 4 e grupit tjetër, i 2 i grupit me të 3 e kështu me radhë.

- 6.1.3. Ndeshjet ne garat e fatosave zgjasin 30 minuta (2x15 min), gjatë zhvillimit te ndeshjes klubet ju lejohet te luajn mbrojtje 3:3, 3:2:1, 5:1 dhe 4:2. Është e ndaluar të luhet 6:0, 5+1, 4+2 dhe mbrojtje flaster. Madhësia e topit 1. Mos respektimi i këtij paragrafi vëzhguesi - kontrolluesi i ndeshjes është i obliguar qe te paraqes ne formularin nr.19 (Fletëparaqitje).
- 6.1.4. Mos respektimi i paragrafit dy (2) do te sanksionohet me 50 euro gjobë, ndërsa në rast të mos paraqitjes nga personat zyrtar (vëzhguesi – kontrolluesi dhe gjyqtarët) do të sanksionohen me 50 euro gjobë.
- 6.1.5. Skuadra e cila renditet e para ne fund te edicionit shpallet Kampion i Kosovës për edicionin e garave 2025/26. Skuadra fituese nderohet me Kupën e FHK-së, kurse 3 skuadrat e para edhe me medalje.

VII. Liga U12

- 7.1. **Gara e grupmoshës U12 djemtë dhe vajzat** zhvillohet gjatë Javës së EHF-së ku do të zhvillohen ndeshje në formë të turneut 2-ditorë në një qytet të caktuar ku do të jetë Festival i Hendbollit për fëmijët e shkollave dhe grupmoshës U12.

Të drejtë pjesëmarrje do të kenë edhe shkollat e programit “Sporti në Shkolla” dhe poashtu klubet e regjistruara në FHK.

Pas çdo grumbullimi do të ndahen Kupa dhe medalje për fituesit e turneut.

Grumbullimet do të jenë çdoherë në qytete të ndryshme nga herat e kaluara.

VIII. Dënimet

- 8.1. Lojtarët dhe personat zyrtarë të shkualifikuar me raport (karton i kaltër), automatikisht suspendohen dhe nuk kanë të drejtë të ushtrojnë funksionin, përkatësisht të drejtë loje deri në marrjen e vendimit nga ana e komisarit të garave.
Në rastë se në ndeshjen e radhas aktivizohet lojtari i suspenduar ose personi zyrtar, ndeshja do të regjistrohet me rezultat me rezultat zyrtar 10:00 për ekipin kundërshtarë dhe ekipi do të dënohet me 100 euro gjobë.

- 8.2. Lojtari, apo personi zyrtar i shkualifikuar për shkak të sjelljeve jo sportive ndaj personave zyrtarë, lojtarëve kundërshtarë apo edhe bashke lojtarëve (kur kemi të bëjmë me kartonin e kaltër), do të dënohet me 2 – 6 ndeshje mos lojë dhe mjete materiale prej:

- 50 euro gjobë për lojtarët e ligës së juniorëve,
- 50 euro gjobë për lojtarët e ligës së kadetëve meshkujt dhe femrat ,
- 50 euro gjobë për lojtarët e ligës së pionierëve fatosave meshkujt dhe femrat.

- 8.3. Ndërsa për trajner dhe persona zyrtarë dënohen me gjobë prej:

- 50 euro për trajner të ligës së juniorëve,
- 50 euro për trajnerët e ligës së kadetëve meshkujt dhe femrat,
- 50 euro për trajnerët e ligës së pionierëve dhe fatosave meshkujt dhe femrat

- 8.4.** Trajneri apo personi zyrtarë i skuadrës i cili ndëshkohet me 2 minuta gjatë ndeshjes për sjellje jo sportive ndaj personave zyrtarë apo skuadrës kundërshtare (lojtarëve, trajnerëve etj) dënohet me gjobë prej:
- 50 euro për trajnerë të ligës së juniorëve,
 - 25 euro për trajnerët e ligës së kadetëve meshkujt dhe femrat
 - 25 euro për trajner e ligës së pionerëve meshkujt dhe femrat
- Skuadra e cili nuk e përmbush obligimin e gjobës së dënimit, mund të zhvillon ndeshjen e radhës por nuk guxon të aktivizohet lojtari, trajneri apo personi zyrtarë i ndëshkuar – dënuar deri në përmbushjen e obligimit.
- 8.5.** Lojtari i shkualifikuar për faul të rëndë (ashpër), gjatë duleit me lojtarin kundërshtarë, apo ne rastet kur ben sjellje jo sportive te ndeshkuar me kartonin e kuq pa raport, automatikisht do të dënohet me gjobitje si vijon:
- 50 euro për lojtarin e ligës së juniorëve
 - 25 euro për lojtarin e ligës së kadetëve meshkujt dhe femrat
 - 25 euro për lojtarin e ligës së pionerëve fatosat meshkujt dhe femrat
- 8.6.** Lojtari i shkualifikuar për faul të rëndë (ashpër), me qëllim të ndërprerjes së aksionit në 30 sekondat e fundit, zhagitja e lojës apo sjelljet tjera sipas rregullës 8:5 dhe 8:6 i cili ndëshkohet me karton të kuq dhe karton të kaltërt automatikisht do të dënohet me 1 (një) ndeshje mos lojë, dhe gjobë me sa vijon:
- 50 euro gjobë për lojtarët e ligës së juniorëve
 - 25 euro gjobë për lojtarët e ligës së kadetëve meshkujt dhe femrat)
 - 25 euro gjobë për lojtarët e ligës së pionerëve dhe fatosave meshkujt dhe femrat
- Portieri i cili shkualifikohet pa raport gjatë intervenimit jashtë zonë së vet (6m), për kontakt me lojtarin kundërshtar nuk do të dënohet me asnjë ndeshje mos lojë, por vetëm me 50 euro gjobitje (nëse kjo nuk ndodh në 30 sekondat e fundit, në rast kur ndodh aplikohet paragrafi më i lart) dhe ka të drejtë aktivizimi në xhiron e radhës.
- 8.7.** Lojtari, trajneri apo personi zyrtarë i cili nuk i përmbush obligimin e gjobës së dënimit, nuk mund të zhvillon ndeshjen e radhës dhe nuk guxon të aktivizohet në lojë deri në përmbushjen e obligimit.

IX. Afatet ligjore

- 9.1.** Anëtarët e Bordit të FHK-së j anë të obliguar që nëse janë prezent në ndeshje të raportojnë me shkrim lidhur me situata e krijuara sidomos ekseseve, me çka do te ndihmohet puna e Komisarit te garave dhe mbarëvajtjes së garave.
- 9.2.** Vendimin për masat disiplinore ndaj lojtarëve, gjyqtarëve, vëzhguesit, kontrolluesit, procesmbajtësit, matësit të kohës, trajnerit, përfaqësueseve të ekipeve etj. në rangun e shkallës së parë e merr Komisari i garave në mbështetje të Rregullores disiplinore të FHK-së dhe dispozitave të këtyre propozicioneve.
- 9.3.** Në ndeshjen e zhvilluar skuadra ka të drejtë ankese e cila paraqitet ekskluzivisht përmes përfaqësuesit të autorizuar të klubit të shënuar në procesverbal të ndeshjes. Paraqitja e ankesës bëhet pas përfundimit të ndeshjes dhe atë në afatin, më së largu 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes ne formularin e posaçëm qe gjendet te vëzhgues-kontrolluesi i ndeshjes (Formulari nr. 20). Me këtë rast nuk është e obliguar të jepet arsyetimi i paraqitjes së ankesës në formularin e posaçëm i cili gjendet tek vëzhgues-kontrolluesi, ndërkaq gjyqtarët dhe vëzhguesi duhet të japin mendimin e tyre lidhur me ankesën e paraqitur.

- 9.4.** Ankesa në regjistrimin e lojtarëve dhe të drejtën e tyre për lojë duhet të paraqitet para fillimit të ndeshjes në procesverbal dhe në formularin e posaçëm (Formulari nr. 20) i cili gjendet tek vëzhgues-kontrolluesi nga përfaqësuesi zyrtarë (me nënshkrim), në të kundërtën ajo nuk do të merret në shqyrtim.
- 9.4.1.** Arsyetimi me shkrim të ankesës të paraqitur nga klubi dorëzohet me së voni 48 orë pas përfundimit të ndeshjes si dhe pagesa e shumës së 50 € për Ligën e juniorëve, 50 € për Ligën e kadetëve meshkujt dhe femratat dhe nga 50 € për Ligat e pionierëve/ve
- 9.4.2.** Vula e postës merret si argument i dorëzimit në afatin e paraparë të ankesës apo postës elektronike nga e-maili zyrtar i ekipit i paraqitur para fillimit të garave si adresë zyrtare e klubit. Arsyetimi me shkrim ndaj ankesës së paraqitur pas afatit të paraparë nuk do të merret në shqyrtim, përkatësisht do të vlerësohet si e paraqitur pas afatit të paraparë.
- 9.4.3.** Përveç çdo paraqitjeje të ankesës brenda 48 orëve ekipi është i obliguar të bëjë pagesën e taksës në shumën prej 50 € te Superliga e meshkujve, 50 € për Superligën e femrave dhe nga 50 € për Ligat e tjera, në të kundërtën ankesa nuk do të merret në shqyrtim, dhe do të konstatohet se ekipi ka hequr dorë nga ankesa.
- 9.4.4.** Për shumën e dorëzuar e të hollave vëzhguesi (apo zyra e FHK-së) lëshon dëshmi, përkatësisht fletëpagesën si dëshmi se është paguar taksa e paraparë për ankesën e paraqitur. Taksën e paguar vëzhguesi është i obliguar ta dorëzojë në arkën apo llogarinë rrjedhëse të FHK-së.
- 9.5.** Kundër vendimit të Komisarit të garave i cili vendos si organ i shkallës së parë, ekipi, respektivisht, lojtarët, gjyqtarët, vëzhgues-kontrolluesi dhe personat e tjerë zyrtarë të pakënaqur më vendimin e organit të shkallës së parë (KG-së) kanë të drejtë ankese organit të shkallës së dytë, Këshillit të garave.
- Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, organit të shkallës së dytë që i paraqitet në afatin prej 8 ditësh nga dita e marrjes së Buletinit të radhës, në të cilin edhe publikohet Vendimi i Komisarit të garave si organ i shkallës së parë, pas pagesës së taksës prej:
- 50 € për ekupe
 - 25 € për persona zyrtarë (gjyqtarë dhe kontrollues-vëzhgues)
- 9.5.1.** Nga pjesa e taksës në shumë prej 50 € gjegjësisht 50 € është i liruar ekipi apo individ i cili të njëjtën e ka paguar me rastin e paraqitjes së ankesës para organit të shkallës së parë (Komisarit të garave). Sipas ankesës Këshilli i garave vendos në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së ankesës. Vendimi i Këshillit të garave është i formës së prerë dhe definitiv në procedurën administrative. Kundër Vendimit të Këshillit të garave pala e pakënaqur mund të ushtrojë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm ligjor, në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit të organit të shkallës së dytë dhe ai i dorëzohet Bordit të FHK-së.
- 9.6.** Ankesa në ndeshjet e garave shtesë (Play-off) i dorëzohet Komisarit të garave në afat prej dymbëdhjetë (12) orëve pas përfundimit të ndeshjes.
- 9.6.1.** Vendimi mbi ankesën në shkallën e parë merret në afat prej njëzetekatër (24) orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim.

- 9.6.2. Në këtë vendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë – Këshillin të garave në afat prej tridhjetegjashtë (36) orëve, i cili vendim do të merret në afat prej dyzetë e tetë orëve (48) orëve.
- 9.7. Të gjitha ndeshjet e zhvilluara Komisari i garave i regjistron në afatin prej 48 orëve e më së voni para fillimit të ndeshjeve të javës në vijim, nga dita e zhvillimit të tyre në bazë të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni zyrtar (procesverbali i ndeshjes, raportet e gjyqtarëve dhe vëzhguesit etj).
- 9.8. Në rast të paraqitjes së ankesës në ndeshje afati i regjistrimit të ndeshjes shtyhet deri në 7 ditë. Në rastet e jashtëzakonshme kur duhet të mblidhen materialet argumentuese për ndeshjen e ndërprerë ajo mund të shtyhet për regjistrim më së largu 15 ditë.

X. Përmbyllja

- 10.1. Interpretimin e këtyre Propozicioneve e bënë Bordi i FHK-së.
- 10.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve të garave të bëhen në të njëjtën mënyrë sikur se edhe janë miratuar.
- 10.3. Çka nuk është paraparë me këto propozicione vlejnë dhe do të zbatohen dispozitat e akteve normative të FHK-së dhe rregullat e EHF-it dhe IHF-it.
- 10.4. Këto Propozicione janë përgatitur nga shërbimi profesional i FHK-së dhe hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Bordi dhe aplikohen për vitin garues 2025/26.

BORDI I FHK-së

Edin Kolgeci d.v.

President